



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Kabineti i Ministres
Kabinet Ministra
Minister's Office

Nr.215/2022

Datë:30.12.2022

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 08/L -117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) nenin 14 (paragrafi 1 nen paragrafi 1,8) të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dhe duke u mbështetur ne nenin 4 te Ligjit Nr.02/L-088 për Trashëgiminë Kulturore, Rregulloren Nr. 11/2022 për Inventarizimin dhe procesin e përzgjedhjes se trashëgimisë kulturore për mbrojtje si dhe duke marre për bazë propozimin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore të datës 30.12.2022 në lidhje me propozimet e shqyrtuara dhe të rekomanduara për përfshirje të aseteve të trashëgimisë kulturore në Listën për Mbrojtje të Përhershme, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Lista e aseteve të Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të përhershme, sipas propozimeve të shqyrtuara nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore për përfshirje të këtyre aseteve në Listën e aseteve me status të mbrojtjes së përhershme.
2. Lista e aprovuar si në pikën një (1) te këtij Vendimi, përfshin 5 (pesë) asete të trashëgimisë kulturore, respektivisht:

- 2.1.Hamami i Madh, Prishtinë;
- 2.2.Varrezat Hebraike në Taukbashqe (Velani),Prishtinë;
- 2.3.Atik Xhamia, Gjilan;
- 2.4.Shkolla e Mesme e Muzikës, Gjilan;
- 2.5.Ish –Hotel “Jadran”, Mitrovicë.

3. Këtij Vendimi i bashkëngjitet edhe Lista e cila konsiderohet pjesë përbërëse e këtij Vendimi .
4. Ky vendim hynë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Komunave përkatëse;
- Inspektoratit për Trashëgimi Kulturorë;
- Departamentit për Trashëgimi Kulturorë;
- Institucioneve të Trashëgimisë Kulturorë;
- QRTK –së përkatëse;
- Agjencionit Kadastral të Kosovës
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MKRS-së.

